



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 1533 / Prot.,
3

Tiranë, më 26/11 /2024

V E N D I M

Nr. 40 , datë . .2024

P Ë R

**PUBLIKIMIN E LISTËS PJESORE TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË 2024-2025, TË
CILËT KANË KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
NGA KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të vendimeve nr. 737, datë 5.12.2024 dhe nr. 738, datë 13.12.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 19.12.2024,

VENDOSI:

1. Të publikojë listën e pjesshme të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.